

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

Pml.nr.6/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKAT SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar i kolegjit, Agim Maliqi dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini Simnica, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të pandehurit L. Z., për shkak të veprës penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 173, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.4. e 1.5., lidhur me nenin 28 e 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, paragrafi 1. të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.363/23 të datës 07.12.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1.DKR.nr.1271/2023 të datës 20.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 09.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e mbrojtësit të pandehurit L. Z. për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr. 363/23 të datës 07.12.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1.DKR.nr.1271/2023 të datës 20.12.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktvendimin PKR.nr.363/23 e datës 07.12.2023, të pandehurit L. Z., ia ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 173, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.4. e 1.5., lidhur me nenin 28 e 31 të KPRK-së dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, paragrafi 1. të KPRK-së, ashtu që sipas këtij aktvendimi paraburgimi do t'i zgjasë deri më datë 08.02.2024. Të pandehurit paraburgimi iu është vazhduar konform dispozitës së nenit 190, lidhur me nenin 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. e 1.2., pikat 1.2.1. e 1.2.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PN1.DKR.nr.1271/2023 të datës 20.12.2023, e ka refuzuar si e pabazuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit dhe ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit L. Z., avokati Përparim Haliti nga P., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1. të KPP-së, dhe shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën, të ndryshojë aktvendimet e kundërshtuara, ashtu që të pandehurit t'ia ndërpres masën e paraburgimit dhe të njëjtit t'i caktoj masën e arrestit shtëpiak, apo të anulohen aktvendimet e kundërshtuara dhe lëndë t'ia kthen gjykatës së shkallës së parë në rivendosije mbi shqiptimin e masës së sigurisë ndaj të pandehurit.

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.III.nr.6/2024 e datës 04.01.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1., lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa e mbrojtësit të të pandehurit është e pabazuar.

Mbrojtësi i të pandehurit në kërkesën e tij pretendon se aktvendimi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë mbi vazhdimin e paraburgimit iu mungon arsytimi sepse fillimisht e trajtojnë veprën si të kryer dhe jo të mbetur në tentativë, se gjendja faktike e përshkruar në aktvendimet e kundërshtuar nuk i përgjigjen gjendjes reale apo faktike se çka realisht kishte ndodhur ditën kritike, duke mos i përshkruar saktë dhe drejtë veprimet respektivisht mos veprimet e të mbrojturit të tij. Gjithashtu, nuk janë plotësuar kushtet ligjore konform dispozitës së nenit 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. e 1.2., pikat 1.2.1. e 1.2.3. të KPP-së, ngase nuk ekziston rreziku i ikjes, si dhe i përsëritjes së veprës penale, ngase i mbrojturi i tij është dorëzuar vullnetarisht në polici dhe se të dëmtuarin e kishte takuar ditën e incidentit, sa i përket përsëritjes së veprës penale i njëjti nuk shquhet për rrezikshmëri dhe se e kaluara kriminale nuk përkon me veprën penale, ka premtuar se do tu përgjigjet rregullisht ftesave të gjykatës dhe se është i gatshëm të ballafaqohet me drejtësinë, andaj, mbrojtja thekson se edhe me masa tjera më të buta mund të sigurohet prezenca e të pandehurit në procedurë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk janë të bazuara për arsye se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 190, paragrafi 1., lidhur me nenin 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. e 1.2., pika 1.2.1. të KPP-së, ngase nga shkresat e lëndës, aktakuzës së ngritur si dhe provave të mbledhura gjerë më tani në këtë çështje juridiko-penale, rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprat penale për të cilat dyshohet dhe ekzistojnë rrethana të cilat më të drejtë justifikojnë frikën

se me gjetjen e të pandehurit në liri, i njëjti do të ikë apo të arratiset, për t'i ikur përgjegjesisë penale dhe pengimin e procedurës penale, pasi që për këto vepra penale parashihen dënime të larta, si dhe duke pasur parasysh faktin se që nga koha e kryerjes së veprave penale i pandehuri kanë qenë në arrati deri më datë 18.03.2023 dhe për kundër fakti se i është lenë ftesa nga ana e policisë që të paraqitet në stacionin policor, mirëpo i njëjti nuk është paraqitur, jep arsye për të besuar se me gjetjen e tij në liri i njëjti do të arratiset me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, e në këtë mënyrë do ta pamundësonte zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Gjithashtu kjo gjykatë, vlerëson se drejtë është konstatuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 190, paragrafi 1., lidhur me nenin 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. e 1.2., pika 1.2.3. të KPP-së, për të pandehurin, duke pasur parasysh peshën e veprës penale, mënyra dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, ku i pandehuri me dashje dhe në bashkëveprim me të pandehurin tjetër në mënyrë dinake, fillimisht e kanë sulmuar të dëmtuarin e më pas kanë shtënë me armë në drejtim të tij dy herë, duke i shkaktuar lëndime në pjesën e kokës (njëra plagë në anën e djathtë ballore afër syrit, ndërsa plaga tjetër në pjesën e majtë të qafës), dhe pasi që binden se i dëmtuari ka ndërruar jetë, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm, vetes i kanë sjellë dobi pasurore të paligjshme, të njëjtin e kanë kontrolluar dhe nga xhepi ia marrin çelësat e veturës, pastaj e mbulojnë trupin e të dëmtuarit me dushk dhe rrema dhe me veturën e tij largohen nga vendi i ngjarjes, si dhe karakteristikat dhe sjelljet e t'ia personale, ku nga data baza e Policisë së Kosovës del se i njëjti edhe më herët ka rënë ndesh me ligjin, sepse në emër të tij ka të evidentuara edhe vepra tjera penale të natyrave të ndryshme, karakteristika këto të cilat konkretizojnë se po të gjendet i pandehuri në liri, ekziston rreziku se i njëjti do të mund ta përsërisë veprën penale të natyrës së njëjtë apo ndonjë vepër tjetër penale, andaj vazhdimi i paraburgimit është i arsyeshëm për rrjedhjen normale të procedurës penale.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo gjykatë, ndërsa masat tjera të parapara nga neni 171 të KPP-së, janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.6/2024, më datë 09.01.2024

Bashkëpunëtorja profesionale,
Mirlinda Mejzini Simnica

Kryetari i kolegjit,
Afrim Shala